**N J O F T I M:**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 135 datë 02.11.2026, i cili ka miratuar fillimin e proçedurave të shpronësimit për pasuritë që preken nga realizimi i projektit me interes publik, ***"Sistemimi dhe asfaltimi i bllokut të rrugëve në lagjen "Skëndërbej": rruga "Ahmet Doraci", rruga "Refik Palloshi", rruga "Spiro Llulla", rruga "Adem Jashari", rruga "Mihal Caridha", rruga "Llambi Sheputi" dhe rruga "Nestor Polomeri", ndodhur në Z.K 8523"***, si dhe mbështetur në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndyshuar, ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, kërkohet që brënda datës 23.11.2026, pronari/ët e pasurive ose të tretë të cilëve i'u preket pasuria, të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Pronave Publike dhe Strehimit, fotokopje të noterizuar të dokumenteve të pronësisë lëshuar nga ASHK Elbasan, si dhe fotokopje karte identiteti.